



17/7 KBU  
25.10.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

V E N D I M

Nr. 9, datë 16/10/2024

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS “PËR MIRATIMIN ME KUSHT TË  
KËRKESËS PËR LEJE “KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM  
BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË(NË  
RASTIN E UJRAVE TË RRJEDHSHËM)NË RAST SE KUR  
PËRDORIMI ËSHTË PËR <= 5 TON/VIT,<=5L/SEK TË  
SUBJEKTIT “ARFAEL CO”.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, VKM-së nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së Këshillit të secilit prej tyre”, VKM-së nr.550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

KONSTATOI SE:

Pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit subjektit “ARFAEL CO” “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshëm) në rastin kur përdorimi është për <=5 ton/vit, <=5 l/sek”, rezultoi se;

1. Subjekti “ARFAEL.CO” në datë 25.02.2015 ka lidhur kontratë me DSHP-në për marrjen e nje sipërfaqeje me qera për ushtrimin e aktivitetit me veprimtari “Ndërtim rezervuaresh me qëllim zhvillimin e akuakulturës”, kontratë e cila përfundon në shkurt 2025. Nga

verifikimet e bëra nga ADZM në terren si dhe nga projekt raporti i bërë nga Drejtoria e Auditit rezultojnë që ky aktivitet nuk është parashikuar në VKM-në Nr.1156 Dt. 24.02.2020 “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifatat që paguhen, në zonë të mbrojtur të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”. Pra kjo kontratë është gjetur me shkelje nga auditi;

2. Ligji për zonat e mbrojtura e ndalon ndërtimin e e këtyre aktivitetëve me bazë betoni;
3. Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural është në proces të studimit “Mbi identifikimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në ujërat e brendshme të republikës së Shqipërisë”. Aktualisht ZPA-të në Ujërat e Brendshme nuk janë të miratuara. Bazuar në pikën 1, të nenit 8, të ligjit Nr.103/2016 “Për Akuakulturën”, i ndryshuar, veprimtaritë e akuakulturës zhvillohet vetëm në sipërfaqe tokësore dhe ujore të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave si Zona të Përcaktuara për Akuakulturë. Përsa kohë që Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë në Ujërat e Brendshme nuk janë miratuar, MBZHR nuk mund të shqyrtojë kërkesat e subjekteve për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe tokësore;

---

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli i Basenit Ujor Erzen bazuar në gjurmën (ç), të pikës 14, të Kreut IV, të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020, dhe në vendimin nr.6, datë 12.06.2019, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor”, të Këshillit Kombëtar të Ujit,

#### **V E N D O S I:**

1. Refuzimin e kërkesës për leje për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për akuakulturë , subjektit “ARFAEL CO” shpk, me vendndodhje Komuna Shën Gjergj, Bashkia Tiranë, sipas këtyre koordinatave:

- X= 505099.5
- Y= 4575729.2
- Z= 631.5 m.m.n.d

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI**

**AFRIM QËNDRO**

